# DEKLARATA PËR MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT

*Deklaratë mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve, grupeve dhe organeve shoqërore në përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura universalisht*

09.12.1998

DATA E **MIRATIMIT TË DEKLARATËS**

E MIRATUAR ME KONSENSUSIN **E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA**

## KUSH JANË **MBROJTËSIT?**

Burra dhe gra të zakonshëm të cilët me veprimtarinë e tyre luftojnë për respektimin e të drejtave të njeriut, për shembull, lirinë e shprehjes, të drejtat e grave, popullatës autoktone ose personave gej, lezbike, transgjinorë dhe interseks. Mund të veprojnë në mënyrë të pavarur ose në kuadër të organizatave.

## SI MUND T'I MBËSHTETNI **MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT?**

- Duke përhapur informacione mbi Deklaratën për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut
- Duke kontribuar në njohjen e punës së mbrojtësve të të drejtave të njeriut
- Duke u ofruar mbështetje organizatave të cilat ndihmojnë dhe mbrojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut
- Duke vepruar në favor të mbrojtësve të ekspozuar ndaj rrezikut
- Duke u bërë vetë mbrojtës i të drejtave të njeriut! Secili ka të drejtë por dhe përgjegjësi për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut

## CILI ËSHTË **STATUSI I DEKLARATËS?**

Deklarata bazohet, konsolidon dhe reflekton të drejtën e detyrueshme ndërkombëtare e cila është relevante për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut

## **TË DREJTAT** DHE **MBROJTJA** QË U **JEPET MBROJTËSVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

- TË PROMOVOJNË TË DREJTAT E NJERIUT NË VENDET E TYRE DHE NË NIVELIN GLOBAL
- TË MBROJNË TË DREJTAT E NJERIUT, NË MËNYRË INDIVIDUALE DHE BASHKË ME TË TJERËT
- TË FORMOJNË SHOQATA DHE ORGANIZATA JOQEVERITARE
- TË TAKOHEN DHE MBLIDHEN NË MËNYRË TË QETË
- TË KËRKOJNË, GJEJNË, MARRIN DHE MBAJNË INFORMACIONE MBI TË DREJTAT E NJERIUT
- TË ZHVILLOJNË DHE DEBATOJNË MBI IDE DHE PARIME TË REJA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË ADVOKOJNË PRANIMIN E TYRE
- TU PARAQESIN KRITIKA DHE PROPOZIME ORGANEVE KOMPETENTE PËR AVANCIMIN E PUNËS SË TYRE SI DHE T'I PARALAJMËROJNË MBI ÇFARËDO RREZIKU MBI REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
- TË ANKOHEN NDAJ POLITIKAVE DHE AKTEVE ZYRTARE QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTAT E NJERIUT SI DHE TË KËRKOJNË RISHQYRTIMIN E TYRE
- TË OFROJNË DHE SIGUROJNË ASISTENCË PROFESIONALE DHE TË KUALIFIKUAR LIGJORE OSE NDONJË KËSHILLË DHE NDIHMË TJETËR NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
- TË JENË TË PRANISHËM NË DEBATET PUBLIKE, PROCEDURAT DHE PROCESET GJYQËSORE PËR TË FORMUAR MENDIME MBI PËRPUTHJEN E TYRE ME LIGJIN KOMBËTAR DHE DETYRIMET E ZBATUESHME NDËRKOMBËTARE MBI TË DREJTAT E NJERIUT
- TË KOMUNIKOJNË NË MËNYRË TË PAPENGUAR ME ORGANIZATAT QEVERITARE DHE JOQEVERITARE
- TË PËRFITOJNË NGA KËSHILLA JURIDIKE
- TË MERREN NË MËNYRË TË LIGJSHME ME VEPRIMTARINË OSE PROFESIONIN E MBROJTËSIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
- TË MBROHEN NË PËRPUTHJE ME TË DREJTËN KOMBËTARE, KUR MARRIN PJESË NË AKTIVITETE PAQËSORE KUNDËR SHKELJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT .
- TË KËRKOJNË, MARRIN DHE PËRDORIN BURIME ME QËLLIMIN E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT

NENET 1,5,6,7,8,9, 11,12 DHE 13

## DETYRAT E SHTETEVE

- MBROJTJA, PROMOVIMI DHE ZBATIMI I TË GJITHA TË DREJTAVE TË NJERIUT
- TË SIGUROJNË QË TË GJITHË PERSONAT QË JANË NËN JURISDIKSIONIN E TYRE TË KENË MUNDËSI TË GËZOJNË TË GJITHA TË DREJTAT E NJERIUT SI DHE LIRITË THEMELORE
- MIRATIMI I HAPAVE TË TILLË LIGJORË, ADMINISTRATIVË DHE TË TJERË, ME TË CILAT DO TË SIGUROHET ZBATIMI I EFEKTSHËM I TË DREJTAVE DHE LIRIVE
- SIGURIMI I MJETEVE EFEKTIVE JURIDIKE PËR PERSONAT TË CILËT PRETENDOJNË SE KANË QENË VIKTIMA TË SHKELJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT
- ZBATIMI I HETIMIT TË SHPEJTË DHE TË PAANSHËM TË SHKELJEVE TË PRETENDUARA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
- NDËRMARRJA E TË GJITHA MASAVE TË NEVOJSHME NË MËNYRË QË TË SIGUROHET MBROJTJA NGA ÇDO LLOJ DHUNE, KËRCËNIMI, HAKMARRJE, DISKRIMINIMI, PRESIONI OSE ÇFARËDO VEPRIMI TJETËR I CILI VJEN SI PASOJË E PUNËS SË TYRE NË REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT
- PROMOVIMI I MIRËKUPTIMIT PUBLIK TË TË DREJTAVE QYTETARE, POLITIKE, EKONOMIKE, SHOQËRORE DHE KULTURORE
- SIGURIMI DHE MBËSHTETJA E KRIJIMIT DHE ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE TË PAVARURA, KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
- PROMOVIMI DHE LEHTËSIMI I MËSIMIT MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË TË GJITHA NIVELET E ARSIMIT ZYRTAR DHE TRAJNIMIT PROFESIONAL

NENET 2,9,12, 14 DHE 15

## PËRGJEGJËSITË E TË GJITHËVE

- PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT, MBROJTJA E DEMOKRACISË DHE INSTITUCIONEVE TË SAJ DHE MOSSHKELJA E TË DREJTAVE TË TË TJERËVE
- PERSONAT E TJERË, QË KANË PROFESIONE TË CILAT MUND TË NDIKOJNË NË TË DREJTAT E TË TJERËVE, SIDOMOS PUNONJËSIT E POLICISË, AVOKATËT, GJYQTARËT DHE TË TJERË, KANË PËR DETYRË T'I MBROJNË KËTO TË DREJTA

NENET 10,11 DHE 18

*Për më shumë informacion:* ***www.protecting-defenders.org***

Design by Oh ! Ilaliss